



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA*

**C.nr.382/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit nga Mitrovica Rr.

kundër të paditurit \_\_\_\_\_ e Mitrovicës - \_\_\_\_\_, baza e kontestit borxh, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë 18.04.2017 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses nga Mitrovica, kundër të paditurit.

DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar tri paga mujore në shumë të përgjithshme prej 1469.64 € si dhe në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit shumë të përgjithshme prej 1469.64 € me kamat vjetore sikurse për mijtet e deponuara bankare pa destinim të caktuar duke filluar nga data 13.07.2016 e deri në pagesën e plotë në afat 7 ditorë nga dita e marrjes së aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

- II. DETYROHET** e paditura \_\_\_\_\_

që paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe në emër të taksës gjyqësore për vendim t'ia paguaj gjykatës shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat 7 ditorë prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

paditësja  
kundër të paditurit

nga Mitrovica ka ngritur padi me datë 13.07.2016,  
e Mitrovicës



Paditësi në padi në shqyrtimin gjyqësor-kryesor të mbajtur në këtë gjykatë dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar me kërkesë që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensoj në emër të pagesës për shpërblim jubilar dhe në emër të pagave përcjellëse të pensionimit o paga mujore ashtu siç parashihet me kontratën Kolektive e datës 14.06.2014 e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Përfaqësuesi i të paditurës

..... në shqyrtimin gjyqësor-kryesor të mbajtur në këtë gjykatë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtoj në tërësi kërkesëpadinë pasi që konsideroj se e njëjta është e pa bazë, nuk gjenë mbështetje ligjore si dhe të paditurës i nevojitet një vendim nga niveli qendrorë për të cilën pretendon paditësja


Me qëllim të vërtetimit në mënyrë të drejt dhe të plot gjendja faktike lidhur me këtë çështje kontestuese, gjykata në procedurën e provave, në shqyrtimin gjyqësor-kryesor me datë 08.02.2017, administroj këto prova: Lexohet vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës e datës 13.05.2016, vendimi i datës 08.07.2015, kontrata e punës e datës 01.03.2015, vendimi mbi sistemimin e punëtorit i datës 27.02.2015, pasqyra e llogaris së bashku me transaksionet e lëshuara nga Raiffaisen Bank në emër të paditëses për periudhën kohore Janar-Korrik 2016.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së (Ligjit të Procedurës Kontestimore), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsyeje:

Nga provat e administruara gjykata ka gjetur se paditësja ka punuar nga viti 01.02.1971 pranë ..... jo vërtetohet nga vendimi i .....

..... gjithashtu kjo vërtetohet edhe nga kontrata e punës e lidhur me kohë të pacaktuar me datë 01.03.2015 në mesë paditëses si punëmarrëse dhe të paditurës si punëdhënëse.

Nga provat e administruara gjykata ka gjetur se paditësja ka arritur moshën e pensionimit dhe zyrtarisht ka dalë në pension me datë 16.05.2016, kjo vërtetohet nga vendimi i lëshuar nga ..... me anë të së cilit paditëses i ndërpritet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore.



Me vendimin e datës 08.07.2015, lëshuar nga Komuna e Mitrovicës-  
vërtetohet se paditësja i pranohet  
përvoja e punës prej 44 vite e 5 muaj.

Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.38 e datës 14.06.2014 e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, neni 36 i cili flet për rregullat e përgjithshme dhe pagat ma saktësisht pika 9 e po të njëjtit nenë thotë citoi "Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë prej pika 9.3 për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë" e në rastin konkret paditësja te e paditura

ka punuar më shumë se 44 vite, ndërsa pika 10 e po të njëjtit nen thotë citoi "Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë paga përcjellëse në lartësi prej 3 pagave sipas mesatare së tri pagave të fundit të punëtorit", andaj nga të lartë cekurat u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj në emër të pagesës për shpërblim jubilar dhe në emër të pagave përcjellëse të pensionimit 6 paga mujore me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar duke filluar nga data 13.07.2016 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në kuptim të nenit 294 lidhur me nenin 378 të LMD-së.

Vendimi për shpenzimet procedurës është bazuar në nenin 452.2 lidhur me nenin 453 të LPK-së ashtu që është obliguar e paditura në emër të taksës për përpilimin e aktgjykimit shumëni prej 20 €.

Nga sa u tha më lartë u vendos sin e dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 143 par 1 të LPK-së

### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.382/2016. dt.18.04.2017

GJYQTARI

Faton Ademi

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
DHE ËSHTË I PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
MITROVICË - MITROVICA

M. P. 15.05.2017

F. P. 15.05.2017